

VENDIM
Nr.719, datë 18.6.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE, TË PËRGJEGJËSIVE DHE TË
MARRËDHËNIEVE, NDËRMJET AUTORITETEVE E STRUKTURAVE TË
MENAXHIMIT TË DECENTRALIZUAR, TË ASISTENCËS SË BASHKIMIT EUROPIAN,
NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË PARAZGJERIMIT (IPA) KOMPONENTI I**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 e 8 të ligjit nr.9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qëllimi

Ky vendim përcakton funksionet e përgjegjësitë, si dhe krijon marrëdhënie të ndërsjella, ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit të decentralizuar, të Asistencës së Bashkimit European, në kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA).

2. Strukturat dhe autoritetet e IPA-së

a) Autoritetet e menaxhimit të decentralizuar të Asistencës së Bashkimit European, në kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA), janë;

- Koordinatori kombëtar i Instrumentit të Parazgjerimit (KKIPA/NIPAC);
- Zyrtari përgjegjës akreditues (ZPA/CAO);
- Zyrtari kombëtar i autorizuar (ZKA/NAO);
- Zyrtari i programit, i autorizuar (ZPA/PAO);
- Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve (CFCU);
- Zyrtarët e lartë të programit, në ministrinë e linjës (ZLP/SPO);
- Drejtuesi i autoritetit të auditit.

b) Strukturat e menaxhimit të decentralizuar të IPA-së janë fondi kombëtar (FK/NF) dhe struktura operative për zbatimin e komponentit I, të përbërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve (CFCU), në Ministrinë e Financave, dhe (ZLP/SPO-të), në ministrinë e linjës.

Autoriteti i auditit është një strukturë funksionalisht e pavarur nga të gjithë aktorët e sistemit të menaxhimit e të kontrollit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, të pranuar, të auditimit.

3. Koordinator kombëtar i Instrumentit të Parazgjerimit (KKIPA/NIPAC)

a) Koordinator kombëtar i Instrumentit të Parazgjerimit (KKIPA/NIPAC) është Ministri i Integritetit.

b) KKIPA/NIPAC-ja është autoriteti i menaxhimit të decentralizuar, i cili, bazuar në pikën 2 të aneksit A të marrëveshjes kuadër (ligji nr.9840, datë 10.12.2007), do të jetë përgjegjës:

- për të siguruar bashkërendimin e përgjithshëm të asistencës së IPA-së;
- për të siguruar partneritet, ndërmjet Komisionit European dhe Republikës së Shqipërisë, si dhe fondet e parazgjerimit të IPA-së të përdoren me efektivitet për zbatimin e përparësive, në kuadër të integritetit european.

c) KKIPA/NIPAC-ja, brenda kompetencave të dhëna, do të kryejë detyrat e mëposhtme:

- Programimin vjetor të komponentit I, të IPA-së;
- Monitorimin, në nivel programi, për komponentët e IPA-së dhe përgatitjen e raportit vjetor dhe final, për zbatimin e IPA-së, të cilin KKIPA/NIPAC-ja do t’ia dërgojë Komisionit European dhe ZKA/NAO-së, bazuar në nenin 38 të marrëveshjes kuadër.

ç) Ministri i Integritetit përcakton, me urdhër të brendshëm, strukturën përgjegjëse në Ministrinë e Integritetit, në mbështetje të rolit dhe funksioneve të KKIPA/NIPAC-së.

d) Ministria e Integritetit, për kryerjen e funksionit të programimit dhe monitorimit, përgatit

manualin e brendshëm të procedurave për KKIPA/NIPAC-në, i cili do të miratohet nga KKIPA/NIPAC-ja.

4. Zyrtari përgjegjës akreditues (ZPA/CAO)

a) Zyrtari përgjegjës akreditues (ZPA/CAO) do të jetë Ministri i Financave.

b) ZPA/CAO-ja është autoriteti i menaxhimit të decentralizuar, i cili jep akreditimin për ZKA/NAO-në dhe fondin kombëtar (FK/NF), për menaxhimin e decentralizuar të komponentëve të IPA-së, bazuar në kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të aneksit A të marrëveshjes kuadër.

c) ZPA/CAO-ja, nëpërmjet auditit të pavarur, kontrollon nëse kriteret e akreditimit për ZKA/NAO-në dhe fondin kombëtar (FK/NF) janë përmbushur, siç përcaktohet në shkronjën “c” të pikës 1 të aneksit A, të marrëveshjes kuadër (ligji nr.9840, datë 10.12.2007).

ç) ZPA/CAO-ja, pas akreditimit të AKA/NAO-së dhe të fondit kombëtar (FK/NF), është përgjegjëse për monitorimin, pezullimin apo tërheqjen e akreditimit të ZKA/NAO-së dhe të fondit kombëtar (FK/NF), si dhe informon për këtë Komisionin Europian, bazuar në shkronjën “b” të pikës 1 të aneksit A të marrëveshjes kuadër.

d) ZPA/CAO-ja organizon mbledhje të rregullta dhe këshillime me autoritetin e auditit, të pavarur nga të gjithë aktorët e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit, për të siguruar funksionimin e rregullt të menaxhimit të decentralizuar të komponentëve të IPA-së.

dh) ZPA/CAO-ja miraton manualin e brendshëm të procedurave, të përgatitur nga Ministria e Financave, për realizimin e funksionimit e saj.

e) ZPA/CAO-ja miraton manualin e brendshëm të procedurave për ZKA/NAO-në dhe manualin e brendshëm të procedurave për fondin kombëtar (FK/NF), të përgatitur nga këta dy të fundit.

ë) ZPA/CAO-ja dhe ZKA/NAO-ja miratojnë manualin e brendshëm të procedurave për strukturën operative CFCU, në Ministrinë e Financave, dhe ZLP/SPO-të, në ministrinë e linjës/institucionet përfituese.

5. Zyrtari kombëtar i autorizuar (ZKA/NAO)

a) ZKA/NAO-ja është një zyrtar i lartë i Ministrisë së Financave, i cili emërohet me urdhër të Ministrit të Financave (ZPA/CAO).

b) ZKA/NAO-ja është një autoritet i menaxhimit të decentralizuar, i cili menaxhon veprimtarinë e fondit kombëtar (FK/NF), si dhe i është besuar përgjegjësia e menaxhimit financiar të fondeve të Bashkimit Europian.

c) ZKA/NAO-ja, në mbështetje të pikës 4 të aneksit A të marrëveshjes kuadër, është përgjegjëse për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve të ekzekutuara brenda sistemit të menaxhimit të decentralizuar, si dhe për funksionimin efektiv të sistemeve të menaxhimit e të kontrollit, në përputhje me IPA-në.

ç) ZKA/NAO-ja, gjatë ushtrimit të funksioneve, përdor kapacitetet e fondit kombëtar (FK/NF).

d) Për realizimin e përgjegjësisë të ZKA/NAO-së, Ministria e Financave përcakton një strukturë organizative, përgjegjëse për auditin e brendshëm, për të siguruar një funksionim efektiv të sistemit të menaxhimit të fondeve të Bashkimit Europian.

dh) ZKA/NAO-ja, i propozon ZPA/CAO-së personin (apo personat), që do të kryejë/në funksionimin e zyrtarit të programit, të autorizuar, (ZPA/PAO), i cili do të drejtojë strukturën operative, pas miratimit nga KKIPA/NIPAC-ja. ZKA/NAO-ja, informon Komisionin Europian për çdo zëvendësim të personit (apo personave), që kryen/jnë këtë funksion.

e) ZKA/NAO-ja është përgjegjëse për akreditimin e strukturës operative për zbatimin e komponentit I të IPA-së, dhe informon Komisionin Europian, në përputhje me nenin 11 të marrëveshjes kuadër. ZKA/NAO-ja akrediton strukturën operative, pasi të sigurohet, bazuar në vlerësimin e një audituesi të pavarur, se kërkesat e parashtruara në nenin 9 të marrëveshjes kuadër janë përmbushur.

ë) ZKA/NAO-ja, pas akreditimit të strukturës operative, sipas shkronjës “g” të këtij neni, është përgjegjëse për monitorimin, pezullimin apo tërheqjen e akreditimit, si dhe për informimin e ZPA/CAO-së, Komisionit Europian në përputhje me nenin 11 të marrëveshjes kuadër.

f) ZKA/NAO-ja monitoron funksionimin e menaxhimit dhe të sistemeve të kontrollit brenda

funksionimit të strukturës operative dhe kontrollon veprimet e ZPA/PAO-së dhe të Drejtorit të Përgjithshëm të njësisë së financimeve dhe kontraktimeve (në vijim referuar si CFCU), si dhe veprimet e strukturave respektive të IPA-së, nëpërmjet ZPA/PAO-së dhe drejtorit të CFCU-së. Nëse ZKA/NAO-ja vëren dobësi në sistemin e menaxhimit dhe të kontrollit, informon ZLP/SPO-të, duke dhënë edhe rekomandime për marrjen e masave të përshtatshme korrigjuese. Nëse SPO-të e emëruara nuk i zbatojnë masat e rekomanduara, ZKA/NAO-ja informon ministrin përkatës.

g) ZKA/NAO-ja mund ta revokojë akreditimin e strukturës operative, nëse strukturat përkatëse nuk eliminojnë dobësitë në sistemin e menaxhimit dhe të kontrollit brenda afateve të përcaktuara.

gj) Në mënyrë që të monitorohet me sukses funksionimi i sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, ZKA/NAO-ja bashkëpunon drejtpërdrejt me autoritetin e auditit, i cili dorëzon edhe një plan pune vjetor auditit, një raport vjetor për veprimtaritë e auditit, si dhe një mendim auditit vjetor të ZKA/NAO-ja.

h) ZKA/NAO-ja, kur është e nevojshme, mund të angazhojë auditues të jashtëm, të pavarur, për të realizuar audite shtesë të të gjitha institucionet e përfshira në menaxhimin e decentralizuar të fondeve të IPA-së, për të siguruar një funksionim eficient dhe efektiv të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, në përputhje me IPA-në.

i) ZKA/NAO-ja është përgjegjëse për identifikimin e çdo parregullsie brenda menaxhimit të decentralizuar dhe për informimin e Komisionit Europian. ZKA/NAO-ja bashkëpunon me strukturën, që do të krijohet për parandalimin, zbulimin, raportimin dhe hetimin e parregullsisë. Marrëdhëniet e ndërsjella, ndërmjet ZKA/NAO-së dhe kësaj strukture rregullohen me një memorandum bashkëpunimi.

j) ZKA/NAO-ja dorëzon deklaratë vjetore garancie pranë Komisionit Europian, në përputhje me nenin 17 të marrëveshjes kuadër. Nëse nuk ka evidenca për funksionimin eficient të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve kryesore, të kërkuara nga deklaratat e garancisë, ZKA/NAO-ja informon Komisionin Europian dhe ZPA/CAO-në për arsyet dhe pasojat e mundshme të çështjes në fjalë, si edhe për masat korrekte të ndërmarra, për kapërcimin e situatës e mbrojtjen e interesave të komunitetit.

k) ZKA/NAO-ja siguron bashkëfinancimet e nevojshme kombëtare, në përputhje me marrëveshjet përkatëse financiare të IPA-së, në mënyrë që të pasqyrohen në buxhetin vjetor të Republikës së Shqipërisë.

l) ZKA/NAO-ja dërgon në Komisionin Europian një parashikim të aplikimeve të pagesave të pritshme për vitin financiar në fjalë dhe për vitet e ardhshme financiare, brenda datës 28 shkurt të çdo viti.

m) ZKA/NAO-ja siguron që sistemi i raportimit financiar të Komisionit Europian (Perseus) të përditësohet rregullisht dhe procedurat raportuese të respektohen nga fondi kombëtar (FK/NF) dhe CFCU-ja.

n) ZKA/NAO-ja merr pjesë në Komitetin e Monitorimit të IPA-së dhe në Komitetin e Monitorimit të Asistencës së Tranzicionit dhe Forcimit Institucional (TAIB).

o) ZKA/NAO-ja miraton procedurat e manualit të brendshëm për fondin kombëtar (FK/NF) dhe CFCU-në.

p) ZKA/NAO-ja, së bashku me ZPA/PAO-në, miratojnë manualin e brendshëm të procedurave për veprimtarinë përkatëse të SPO-ve, në kuadër të menaxhimit të decentralizuar të komponentit I të IPA-së, pas miratimit të tyre nga ministria e linjës. ZKA/NAO-ja ia dërgon ZPA/CAO-së këto manuale të përmendura në shkronjat “o” e “p” të kësaj pike.

6) Fondi kombëtar (FK/NF)

a) Fondi kombëtar (FN/NF) është struktura qendrore e thesarit, nëpërmjet së cilës fondet e parazgjerimit nga Komisioni Europian do t'i transferohen Republikës së Shqipërisë sipas pikës 5 të aneksit A të marrëveshjes kuadër, e cila zbaton dhe siguron funksionimin eficient të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, sipas përcaktimeve të pikës 4 të aneksit A të marrëveshjes kuadër. Kjo strukturë (drejtori në Ministrinë e Financave) krijohet me urdhër të Ministrit të Financave.

b) Roli dhe përgjegjësitë e fondit kombëtar (FN/NF) pasqyrohen në rregullorën e brendshme të Ministrisë së Financave.

c) Drejtuesi i fondit kombëtar (FK/NF) raporton drejtpërdrejt te ZKA/NAO-ja dhe është përgjegjës për funksionimin dhe realizimin e veprimtarisë së fondit kombëtar (FK/NF).

ç) Fondi kombëtar (FK/NF) është përgjegjës për menaxhimin financiar të IPA-së, të menaxhuar nga ZKA/NAO-ja, dhe kryen detyrat e mëposhtme:

- Çel dhe menaxhon llogaritë bankare;
- Kërkon fonde nga Komisioni Europian;

- Miraton transferimin e fondeve nga Komisioni Europian të strukturat operative për katër komponentët I të IPA-së ose te përfituesit përfundimtarë të IPA-së;

- Dërgon raporte financiare pranë Komisionit Europian.

d) Me kërkesë të ZKA/NAO-së, fondi kombëtar (FK/NF) kryen kontrolle, në vend, në të gjitha ministritë e linjës apo institucionet përfutuese të IPA-së për monitorimin më eficient të funksionimit të sistemeve të menaxhimit dhe të kontrollit.

dh) Gjatë ushtrimit të kompetencave të tij për menaxhimin financiar të IPA-së, fondi kombëtar (FK/NF) bashkëpunon me Bankën e Shqipërisë (BSH), ku ZKA/NAO-ja hap llogari bankare, në monedhë të huaj për të transferuar fondet nga Komisioni Europian për secilin komponent të IPA-së. Marrëdhëniet e ndërsjella, ndërmjet ZKA/NAO-së, FK/NF-së, CFCU-së dhe BSH-së rregullohen me një marrëveshje të veçantë, që përcakton afatet dhe kushtet për përdorimin e llogarive bankare në monedhë të huaj, të çelura në Bankën e Shqipërisë.

e) Ndarja e roleve dhe e përgjegjësi, ndërmjet ZKA/NAO-së, fondit kombëtar (FK/NF) dhe strukturës operative, brenda menaxhimit të decentralizuar të IPA-së, komponenti I, dhe marrëdhëniet e tyre të ndërsjella, përcaktohen në një marrëveshje zbatimi, ndërmjet ZKA/NAO-së, dhe ZPA/PAO-së, ku përshkruhen rolet dhe përgjegjësitë e palëve kontraktuese, procedurat e transferimit dhe metodat e përdorimit të fondeve, dispozitat për bashkëfinancimin, mekanizmat e kontrollit financiar, menaxhimin e llogarive bankare, kontabilitetin dhe auditimin.

7. Zyrtari i programit i autorizuar (ZPA/PAO)

a) Zyrtari i programit, i autorizuar, (ZPA/PAO) është një zyrtar i lartë në Ministrinë e Financave, i emëruar nga ZPA/CAO-ja, që drejton strukturën operative për zbatimin e komponentit I të IPA-së, i cili përgjigjet te ZKA/NAO-ja, për përmbushjen, në kohën e duhur dhe me efikasitet, të detyrimeve, të përcaktuara në pikën 6 të aneksit A të marrëveshjes kuadër (ligji nr.9840, datë 10.12.2007).

b) ZPA/PAO-ja është përgjegjëse për veprimtarinë e strukturës operative, që përfshin CFCU-në dhe ZLP/SPO-të, të emëruar në ministritë e linjës apo në institucione të tjera, përfutuese të IPA-së.

c) ZPA/PAO-ja konfirmon ose kundërshton, me shkrim, emërimin e personave në detyrën e ZLP/SPO-ve, në ministritë e linjës, të kryer zyrtarisht nga ministrat përkatës.

ç) ZPA/PAO-ja, bazuar në paragrafin e tretë të nenit 8 të marrëveshjes kuadër, nënshkruan një marrëveshje operative me ZLP/SPO-të për delegimin e disa detyrave të caktuara në strukturat e IPA-së, për zbatimin e decentralizuar të projekteve, të financuara nga IPA-ja.

d) ZPA/PAO-ja, para se të nënshkruajë marrëveshjen operative me personin e ngarkuar, në bazë të shkronjës “d” të këtij neni, vlerëson gatishmërinë dhe kompetencat e atij personi për të kryer me sukses funksionin e ZLP/SPO-ve.

dh) ZPA/PAO-ja është përgjegjëse për menaxhimin dhe zbatimin e programit kombëtar të Republikës së Shqipërisë për komponentin I të IPA-së, në përputhje me parimet e menaxhimit, financiar të shëndetshëm dhe mbikëqyrjen përgjatë zbatimit të projekteve të financuara nga IPA-ja, bazuar në marrëveshjen operative të nënshkruar.

e) Nëse ZLP/SPO-të nuk i përmbushin siç duhet detyrat e deleguara nga marrëveshja operative, ZPA/PAO-ja duhet t’u propozojë ministrave të linjës masa të caktuara për të kapërcyer situata të tilla.

ë) ZPA/PAO-ja është përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve të marrëveshjes operative ose të çdo dokumenti tjetër, të nënshkruar, siç përshkruhet në paragrafin e tretë të nenit 8 të marrëveshjes kuadër.

f) ZPA/PAO-ja është përgjegjëse për krijimin e një sistemi të përshtatshëm monitorimi, për të siguruar një nivel të kënaqshëm të mbikëqyrjes së strukturave të IPA-së.

g) ZPA/PAO-ja vlerëson kapacitetet e strukturës operative të OPA-së (CFCU dhe ZLP/SPO-të), në ministritë e linjës/institucionet përfituese të IPA-së) të paktën një herë në vit dhe vë në dijeni, për këtë, ZKA/NAO-në.

gj) ZPA/PAO-ja, gjatë kryerjes së detyrave, përgjigjet te ZKA/NAO-ja dhe e informon atë për çdo ndryshim thelbësor të sistemit, brenda tri ditëve pune.

8. Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve (CFCU)

a) Drejtori i CFCU-së është përgjegjës për menaxhimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve (CFCU), në Ministrinë e Financave.

b) Drejtori i CFCU-së është përgjegjës për zbatimin e programeve të financuara nga komponenti I, i IPA-së dhe përgjigjet te ZPA/PAO-ja, për përmbushjen, në kohë dhe me efikasitet, të detyrimeve, sipas pikës 6 të aneksit A të marrëveshjes kuadër.

c) ZPA/PAO-ja mund t'i delegojë disa nga kompetencat e veta drejtorit të CFCU-së, si drejtues i strukturës operative për komponentin I të IPA-së, me anë të një dokumenti zyrtar, të nënshkruar prej tij.

9. Zyrtarët e lartë të programit (ZLP/SPO)

a) ZLP/SPO-ja është një person i emëruar në ministrinë e linjës apo në institucionin përfitues për komponentin I, të IPA-së, përgjegjës për aspektet teknike të projekteve, që do të zbatohen në ministrinë e linjës apo në institucionin përfitues, që ndihmon ZPA/PAO-në në përgatitjen dhe zbatimin e projektit, në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme, duke qenë përgjegjës për bashkërendimin e çdo përparësie të vendosur në projektin e propozuar.

b) ZLP/SPO-ja kryen detyrat e mëposhtme:

- Informon ZPA/PAO-në dhe drejtorin e CFCU-së, për çdo dyshim për ekzistencën e ndonjë parregullsie apo të çdo lloj parregullsie të përcaktuar, që evidentohet gjatë zbatimit të projekteve të IPA-së.

- Bashkërendon rregullisht me auditin e brendshëm gjatë zbatimit të projekteve të IPA-së dhe informon ZPA/PAO-të dhe drejtorin e CFCU-së për rekomandimet e auditit të brendshëm dhe mënyrën e zbatimit të tyre.

- Informon ZPA/PAO-të dhe drejtorin e CFCU-së për problemet apo rreziqet e mundshme, që lidhen me zbatimin e projekteve të IPA-së.

c) Gjatë kryerjes së detyrave, sipas marrëveshjes operative (ndërmjet ZPA/PAO-së dhe ZLP/SPO-të) për zbatimin e projekteve të IPA-së, ZLP/SPO-ja përgjigjet te ministri përkatës, ZPA/PAO-ja dhe drejtori i CFCU-së.

ç) ZLP/SPO-ja menaxhon strukturat e IPA-së në ministritë e linjës/institucionet përfituese, që do ta mbështesin atë gjatë kryerjes së rolit dhe të detyrave, që lidhen me zbatimin e projekteve të IPA-së.

d) ZLP/SPO-ja është përgjegjëse për informimin në kohë të ministrit përkatës, të ZPA/PAO-së dhe të drejtorit të CFCU-së për çdo ndryshim në menaxhimin e burimeve njerëzore në strukturën e IPA-së, që ai drejton.

10. Strukturat operative për zbatimin e komponentit I të IPA-së (TAIB)

a) Në bazë të pikës 6 të aneksit A të marrëveshjes kuadër të IPA-së, në strukturën operative për zbatimin e komponentit I, përfshihen CFCU-ja dhe strukturat e IPA-së, në ministritë e linjës dhe në institucione të tjera, që zbatojnë projekte të financuara nga komponenti I i IPA-së.

b) Struktura operative drejtohet nga ZPA/PAO-ja.

c) Audit i brendshëm, brenda në Ministrinë e Financave, ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera përfituese të IPA-së, kryen funksionet dhe detyrat, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës, për veprimtarinë e strukturës operative për komponentin I të IPA-së.

ç) CFCU-ja, në Ministrinë e Financave, është përgjegjëse e vetme për kryerjen e procedurave të tenderimit e të kontraktimit, për regjistrimin e transaksioneve në sistemin e kontabilitetit, kryerjen e pagesave për kontratat e lidhura për projektet e financuara nga komponenti I i IPA-së, monitorimin operacional (në nivel projekti) dhe kontrollin e brendshëm, në bazë të kërkesave të sistemit të menaxhimit të decentralizuar të IPA-së.

d) ZPA/PAO-ja mund të delegojë disa prej detyrave të përshkruara në pikën 6 të aneksit A të marrëveshjes kuadër, e ZLP/SPO-ve, nëpërmjet marrëveshjes operative.

dh) CFCU-ja, si pjesë e strukturës operative, mbikëqyr zbatimin e projekteve të sistemit të menaxhimit të decentralizuar të IPA-së në Republikën e Shqipërisë, të financuara nga komponenti I i IPA-së.

e) CFCU-ja është përgjegjëse për menaxhimin dhe zbatimin e programit kombëtar të Republikës së Shqipërisë për komponentin I të IPA-së, në përputhje me parimet e menaxhimit financiar të shëndetshëm dhe të mbikëqyrjes për zbatimin e projekteve të financuara nga IPA-ja, sipas marrëveshjes operative të nënshkruar.

ë) Strukturat e IPA-së, të drejtuara nga ZLP/SPO-të, janë përgjegjëse për kryerjen e detyrave, që lidhen me zbatimin teknik të projekteve përkatëse, sipas dispozitave të marrëveshjes operative.

f) CFCU-ja, me urdhër të ZPA/PAO-së, ka të drejtë të kryejë kontrolle në vend dhe, kur vëren mangësi në veprimtari, mund të marrë masa për eliminimin e këtyre mangësive, me qëllim zbatimin efektiv dhe në kohë të projekteve nga strukturat e IPA-së.

g) Nëpunësit e CFCU-së, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, zbatojnë dispozitat e manualit të brendshëm të procedurave për CFCU-të, nënshkruar nga ZPA/PAO-ja dhe miratuar nga ZKA/NAO-ja.

gj) Nëpunësit e strukturës operative, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, për zbatimin e projekteve të IPA-së, zbatojnë dispozitat e manualeve të brendshme të procedurave.

11. Autoriteti i auditit

Autoriteti i auditit krijohet si strukturë brenda Kontrollit të Lartë të Shtetit.

a) Bazuar në pikën 7 të aneksit A të marrëveshjes kuadër të IPA-së, krijohet autoriteti i auditit për fondet e Bashkimit Europian, i cili do të jetë funksionalisht i pavarur nga të gjithë aktorët, në sistemin e menaxhimit të decentralizuar dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, të pranuara.

b) Autoriteti i auditit është përgjegjës për verifikimin e funksionimit efektiv të sistemit të menaxhimit dhe të kontrollit.

c) Autoriteti i auditit kryen funksionet e mëposhtme:

- krijon një plan auditit vjetor;
- dorëzon raportet dhe mendimet, si më poshtë vijon:

i) raportin e veprimtarisë audituese vjetore (në përputhje me kërkesat e aneksit C të marrëveshjes kuadër të IPA-së);

ii) mendimin e auditit vjetor (në përputhje me kërkesat e aneksit D të marrëveshjes kuadër të IPA-së);

iii) mendimin për çdo deklaratë përfundimtare të ZKA/NAO-së (në përputhje me kërkesat e aneksit E të marrëveshjes kuadër të IPA-së).

- Përbush kërkesa të tjera specifike për planin e auditit vjetor, raportet dhe mendimet, në përputhje me marrëveshjet financiare.

- Harton metodologjinë e punës për fondet e Bashkimit Europian, e cila duhet të përmbushë standardet ndërkombëtare të pranuara, si dhe bën vlerësimin e riskut në veçanti, me dëshmi materiale dhe shembuj. Kjo metodologji mund të plotësohet dhe përmirësohet në bashkëpunim me Komisionin Europian.

ç) Pjesë e autoritetit të auditit janë këshilli i menaxhimit dhe drejtori i autoritetit të auditit.

d) Autoriteti i auditit menaxhohet nga këshilli i menaxhimit, i përbërë nga një drejtues dhe dy anëtarë.

dh) Të gjitha çështjet e tjera, që kanë lidhje me organizimin dhe funksionimin e autoritetit të auditit, rregullohen nga statusi i këtij autoriteti.

12. Komiteti i monitorimit të IPA-së dhe komiteti i monitorimit të komponentit I të IPA-së (TAIB)

a) Në bazë të nenit 36 të marrëveshjes kuadër të IPA-së, për menaxhimin e decentralizuar të IPA-së, krijohen:

i) komiteti i monitorimit të IPA-së, për të gjithë komponentët e IPA-së;

ii) komiteti i monitorimit të komponentit I të IPA-së (TAIB).

b) Komiteti i monitorimit të IPA-së është struktura kryesore përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të të gjithë asistencës të IPA-së, bazuar në paragrafin e tretë të nenit 36 të marrëveshjes

kuadër dhe të rregullores operative të komitetit të monitorimit të IPA-së. Ky komitet përbëhet nga përfaqësues të Komisionit European, ZKA/NAO-ja, FK/NF-ja, KKIPA/NIPAC-ja, ZPA/PAO-ja dhe CFCU-ja. Përfaqësueses të Komisionit European dhe KKIPA/NIPAC-ja do të bashkëdrejtojnë komitetin, ndërsa drejtoria teknike e KKIPA/NIPAC-së do të kryejë funksionin e sekretariatit të komitetit e do të jetë përgjegjëse për përgatitjen dhe dorëzimin e të gjitha dokumenteve, që do të diskutohen dhe rishikohen nga komiteti.

c) Komiteti i monitorimit të komponentit I të IPA-së (TAIB) është përgjegjës për zbatimin e programeve të IPA-së, komponenti I, në përputhje me rregulloren operative të komitetit të monitorimit sektorial për këtë komponent. Ky komitet përbëhet nga përfaqësues të KKIPA/NIPAC-së, ZKA/NAO-ja, FK/NF-ja, CFCU-ja, Komisionit European, partnerë socialë dhe organizata të shoqërisë civile. Përfaqësuesit e KKIPA/NIPAC-së do të drejtojnë komitetin, ndërsa drejtoria teknike e KKIPA/NIPAC-ja, në Ministrinë e Integritetit, do të kryejë funksionin e sekretariatit të komitetit dhe do të jetë përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e dokumenteve, që do të diskutohen dhe rishikohen nga komiteti.

13. Auditi i brendshëm

a) Ministrat e linjës/drejtuesit e institucioneve përfituese të IPA-së janë përgjegjës për krijimin/funksionimin e kontrollit të brendshëm në institucionet e tyre, në përputhje me ligjin nr.9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

b) Njësitë e auditit të brendshëm do të kryejnë kontrollin e brendshëm vjetor në të gjitha strukturat dhe projektet e IPA-së, në bazë të planit vjetor të miratuar nga ministrat e linjës/drejtuesit e institucioneve përfituese, një kopje e të cilit duhet të dorëzohet të ZKA/NAO-ja.

c) ZKA/NAO-ja nxjerr udhëzime për të gjitha strukturat e IPA-së, në bazë të rekomandimeve të çdo raporti të auditit të brendshëm.

ç) ZLP/SPO-ja, pasi merr udhëzimet e ZKA/NAO-së, për rekomandimet e auditit të brendshëm, brenda 30 ditëve, duhet të dorëzojë te ZKA/NAO-ja dhe ZPA/PAO-ja informacionin për masat e marra, si dhe një plan veprimi për masat korrigjuese, që do të zbatohen brenda një afati të caktuar.

14. Ministrinë e linjës dhe strukturat e IPA-së

a) Ministri i linjës/drejtuesi i institucionit përfitues cakton një person për kryerjen e funksionit të ZLP/SPO-së, si dhe e autorizon atë të nënshkruajë marrëveshjen operative me ZPA/PAO-në akte të tjera, që lidhen me projektet e financuara nga IPA-ja.

b) Ministrat e linjës/drejtuesit e institucioneve përfituese të IPA-së dhe ZLP/SPO-të respektivë, në bashkëpunim me ZPA/CAO-në, duhet të organizojnë, rregullisht, mbledhje dhe të bashkëpunojnë rregullisht me ZKA/NAO-në, FK/NF-në, ZPA/PAO-në e CFCU-në, për kapërcimin në kohë të të gjitha mangësive të evidentuara gjatë procesit të zbatimit të projekteve të financuar nga IPA-ja.

c) Ministrinë e linjës/drejtuesit e institucioneve përfituese të IPA-së do t’u sigurojnë ZLP/SPO-ve personelin e nevojshëm dhe të kualifikuar, bazuar në analizën e ngarkesës së punës, si dhe fondet e nevojshme për zbatimin e projekteve të financuara nga IPA-ja, brenda buxhetit respektiv të ministrisë së linjës/institucionit përfitues të IPA-së.

ç) Ministri i linjës/drejtuesi i institucionit përfitues duhet të informojë ZPA/PAO-në për çdo zëvendësim të ZLP/SPO-ve në institucionet e tyre, dhe ZPA/PAO-ja do të informojë, për këtë, ZKA/NAO-në.

d) Strukturat përgjegjëse për menaxhimin e decentralizuar të IPA-së në ministrinë e linjës do të kryejnë funksionet e tyre dhe do të mbajnë përgjegjësi brenda kompetencave, bazuar në marrëveshjen operative (ndërmjet ZPA/PAO-së dhe ZLP/SPO-së) si dhe rregulloren e brendshme të ministrisë përkatëse.

15. Dispozita kalimtare

a) Ministrinë dhe institucionet përfituese të IPA-së duhet të përshtasin rregulloret e brendshme të institucioneve të tyre përkatëse me masat e përcaktuara në këtë vendim për një periudhë 6-mujore, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

b) Vendimi nr.596, datë 5.9.2007 i këshillit të Ministrave “Për ngritjen e strukturave dhe përcaktimin e autoriteteve e të përgjegjësive për zbatimin e Instrumentit të Parazgjerimit”,

shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha